

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Një ankesë kundër: **KUVENDI KOMUNAL I PRIZRENIT**
(Shëno emrin e Autoritetit Kontraktues)

Për Aktivitetin e Prokurimit Nr. i AP: **622-25-4712-5-1-1**
(Shëno numrin e Aktivitetit të Prokurimit)

Sa i përket tenderit për: **Renovimi i tërësishëm i objektit shkollor Dëshmorët e Zhurit Zhur projekt 2 vjeçar**
(Shëno titullin e kontratës si në Dosjen e Tenderit)

ANKESË

1. Identifikimi i ankuesit*

“AAB CONSTRUCTION” SH.P.K
(Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj)

Luan Haradinaj sol1 HY 1 nr. 4
(Adresa)

Prishtinë
(Vendi)

10000
(Kodi postar)

044 281 360
(Numri Telefonit)

(Numri i Faks-it)

Arlind Buzhala
(Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj)

constructionaab@gmail.com
(Adresa elektronike)

30.06.2025
(Data e parashtrimit të ankesës)


(Nënshkrimi dhe vula)

*Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.

2. Identifikimi i avokatit

*Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.
Shëno të dhënat si në vijim:*

(Emri i avokatit)

(Adresa e plotë)

(Numri i Telefonit)

(Numri i faks-it)

(Adresa elektronike)

(Data e parashtrimt të ankesës)

(Nënshkrimi dhe vula)

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

[Shëno një përshkrim të shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar “ Njoftimi për Kontratë” apo “Njoftimi për konkurs të projektimit” dhe, nëse aplikohet “Njoftimi për dhënie të Kontratës”, “Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit” apo “Njoftimi për anulim të aktivitetit të prokurimit”, nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës]:

- Njoftimi për kontrate i datës **29.05.2025**
- B54 Formulari standard për korrigjimin e gabimeve në njoftimet e publikuara **05.06.2025**
- B54 Formulari standard për korrigjimin e gabimeve në njoftimet e publikuara **18.06.2025**
- Kërkesa për rishqyrtim: **18.06.2025**
- Pergjigjia e kërkesës për rishqyrtim: **20.06.2025**

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, nëse aplikohet

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po ☐

Jo ☐

Procedura është ende në fazën tenderuese

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, nëse aplikohet

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po ☐

Jo ☐

6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

A keni bërë kërkesë për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?

Po ☐

Jo ☐

Nëse po, ofroni detaje mbi këtë fakt dhe bashkëngjit një kopje të vendimit të miratuar nga AK gjatë kontekstit paraprak të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve në përputhje me nenin 108A të LPP-se.

Zyra e Prokurimit e Autoritetit Kontraktues: Kuvendi Komunal i Prizrenit, me datën **29.05.2025**, ka publikuar njoftimin për kontratë.

Pas shqyrtimit të kriterëve të vlerësimit, më datë **18.06.2025** kemi parashtruar kërkesë për rishqyrtim.

Kjo kërkesë është refuzuar më datë **20.06.2025**

Megjithatë, disa nga kriteret e vlerësimit, të cilat nuk kanë lidhje me lëminë e kontratës, nuk janë ndryshuar dhe nuk janë aprovuar nga Autoriteti Kontraktues.

7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs të Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

Shkeljet e LPP-se nga ana e AK-së:

Neni 1 Qëllimi

Neni 6 Ekonomiciteti dhe Efikasiteti

Neni 7 Barazia në Trajtim/ Jo-Diskriminimi

Neni 52 Njoftimi i kriterëve për dhënien e kontratës

Neni 56 Dispozitat e Përgjithshme mbi Përzgjedhjen e Pjesëmarrësve dhe Dhënien e Kontratave

Neni 60 Kriteret për Dhënien e Kontratës.

Neni 65 Provueshmëria e Kandidatëve ose Tenderuesve

Neni 69 Aftësia Teknike dhe/ose Profesionale

Neni 72 Dokumentacioni dhe informacioni shtesë

Gjithashtu AK ka shkelur edhe dispozitat përkatëse të RrUOPP-se.

*** Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthejë tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkojë një jobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kanë qenë të rrejshme ose mashtruese.*

8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

Te pa kënaqur me vendimin e date 20.06.2025 pas kërkeses për rishqyrtim ndaj AK **KUVENDI KOMUNAL I PRIZRENIT** në lidhje me aktivitetin e prokurimit: **Renovimi i tërësishëm i objektit shkollor Dëshmorët e Zhurit Zhur projekt 2 vjeçar** me nr. të prokurimit: **622-25-4712-5-1-1** në afatin ligjor konform ligjit, ushtrojmë këtë:

A N K E S Ë

Për shkak se AK- **KUVENDI KOMUNAL I PRIZRENIT**.

Në këtë procedurë tenderimi, Autoriteti Kontraktues ka vendosur kriteret e vlerësimit në mënyrë të kundërligjshme. Këto kriteret shkelin parimet bazë të ligjshmërisë: Vendorsja e kriterëve të tilla nuk është në përputhje me dispozitat e Ligjit për Prokurimin Publik dhe aktet nënligjore që rregullojnë procedurat e tenderimit. Disa nga kriteret favorizojnë në mënyrë të padrejtë një operatorë ekonomikë, duke i vendosur ata në një pozitë të privilegjuar ndaj konkurrentëve të tjerë. Kjo bie ndesh me parimin e trajtimit të barabartë të të gjithë pjesëmarrësve.

Disa nga kriteret e vendosura nuk kanë lidhje të drejtpërdrejtë me fushën apo lëminë e kontratës, çka shkakton kufizime të panevojshme në konkurrencë. Përmes këtyre kriterëve të padrejta, është penguar mundësia e operatorëve ekonomikë të kualifikuar dhe të cilët përmes prezantimit të listës së projekteve të përfunduara më parë e dëshmojnë edhe përvojën që posedojnë për të konkurruar në

mënyrë të ndershme dhe të barabartë.

Një veprim i tillë me vendosjen e kriterëve cenon integritetin e procesit të prokurimit publik dhe krijon rrezik për mosarritjen e një vlere të mirëfilltë për parane publike, për shkak të kufizimit të konkurrencës dhe përzgjedhjes së ofertave më pak të favorshme. Ky veprim jo vetëm që është në kundërshtim me dispozitat ligjore për prokurimin publik, por gjithashtu dëmton transparencën dhe ndershmërinë që duhet të karakterizojnë një proces të tillë.

Sa për sqarim Autoriteti Kontraktues (AK) ka zhvilluar njëkohësisht tre aktivitete të renovimit të shkollave, të cilat janë aktivitete të ngjashme me natyrë dhe veprimtari pothuajse identike mirepo kriteret janë kriterë të cilat janë diskriminuese pasi që për secilën procedurë janë vendosur kriterë komplet ndryshe pavarësisht që e janë të njëjtës natyrë të punimeve.

•Renovimi i objektit shkollor në fshatin Gjonaj (objekti i vjetër) Projekt 2 vjeçar nr.prokurimit: [622-25-4799-5-2-1](#)

•Renovimi i objektit shkollor SHMU Hysen Rexhepi nr.prokurimit: [622-25-4704-5-2-1](#)

•Renovimi i objektit shkollor Mustafa Bakia në Prizren nr.prokurimit: [622-25-5172-5-2-1](#)

Kriteret e ndryshme të vlerësimit krijojnë diskriminim midis operatorëve ekonomikë, duke e favorizuar një në procedurë dhe duke i penalizuar në një tjetër, pavarësisht se punët janë të njëjta.

Ligji për Prokurimin Publik kërkon që operatorët ekonomikë të trajtohen në mënyrë të barabartë dhe të paanshme, veçanërisht kur bëhet fjalë për projekte të ngjashme. Përdorimi i kriterëve të ndryshme për aktivitete të njëjta bie ndesh me këtë parim.

Kjo qasje jo vetëm që cenon konkurrencën e drejtë, por gjithashtu ndikon negativisht në besimin ndaj procesit të prokurimit publik. Përzgjedhja e kriterëve të ndryshme dhe arbitrarë për aktivitete të ngjashme krijon perceptimin e favorizimit dhe mungesës së transparencës. Duke pasur parasysh që natyra e projekteve dhe punëve është e njëjtë, është e domosdoshme që kriteret e vlerësimit të jenë uniforme dhe të bazuara në objektivitet dhe ligjshmëri.

Kjo jo vetëm që siguron konkurrencë të ndershme, por gjithashtu garanton që fondet publike të shfrytëzohen në mënyrën më efikase dhe transparente.

Ne do shtjellojmë më posht kriteret dhe shkeljet në këtë procedurë për të cilën parashtrijmë edhe ankesën:Kërkesa3.Operatori Ekonomik duhet te ketë ne liste te paktën këtë staf profesional.

Në vijim të shqyrtimit të dokumentacionit të tenderit, kërkojmë që të rishikohet dhe largohet kërkesa për posedimin e Licencës A për Menaxherin e Projektit – Inxhinier i Diplomuar i Ndërtimtarisë apo Master – Drejtimi Konstruktiv.

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, së bashku me Odën e Inxhinierëve, është ende në fazën fillestare të procesit të licensimit. Aktualisht, shumë inxhinierë janë ende në pritje të procesit të licensimit, dhe ky proces sapo ka filluar të zhvillohet nga Oda e Inxhinierëve.

Kërkesa për një licencë të tillë mund të krijojë një hendek të panevojshëm dhe të padrejtë në mes të inxhinierëve që janë ende në pritje të përfundimit të këtij procesi dhe atyre që e kanë marrë licencën më herët.

Konsiderojmë se kërkesa për përvojë pune prej së paku 6 vite pas diplomimit është një garanci e mjaftueshme për të siguruar cilësinë dhe kompetencën e Menaxherit të Projektit.

Për këto arsye, propozojmë që të largohet ose të zëvendësohet kjo kërkesë me kriterë të tjera që nuk diskriminojnë ndaj inxhinierëve që janë ende në procesin e licensimit nga Oda e Inxhinierëve.

Udheheqes i punishtes Inxhinier i Diplomuar i Ndërtimtarisë apo master - Drejtimi Hidroteknikë - me përvojë pune min. 3 vite pas diplomimit, te jete i qertifikuar si ekspert i sigurisë dhe shendetit në punë nga MPMS MFPT.

Duke marrë parasysh se MPMS/MFPT ka licensuar kompani për certifikimin e ekspertëve të sigurisë dhe shëndetit në punë, kërkojmë që të mundësohet pranimi i certifikimeve të ofruara nga këto kompani të licensuara.

Procesi i certifikimit nga MPMS/MFPT është deleguar edhe te kompani të licensuara që operojnë me kompetencë dhe në përputhje me rregullat dhe standardet e njëjta. Pranimi i certifikimeve të ofruara nga këto kompani lehtëson pjesëmarrjen dhe promovon konkurrencën. Certifikatat e lëshuara nga kompani të licensuara garantojnë të njëjtin nivel të standardeve dhe cilësisë si ato të ofruara direkt nga MPMS/MFPT.

Mundësimi i përdorimit të certifikimeve nga kompani të licensuara siguron trajtim të barabartë dhe krijon kushte më gjithëpërfshirëse për operatorët ekonomikë që plotësojnë kushtet e tjera të tenderit. Si të tillë kërkojmë që të largohet kërkesa e ofrimit inxhinierit të certifikuar për siguri dhe shendetit në punë nga MPMS MFPT.

Një Inxhinier i Diplomuar i Elektroteknikes me master - me përvojë pune min. 5 vite pas diplomimit, I licensuar nga Ministria e Mjedisit, planifikimit hapsinor dhe infrastruktures- Licenca A.

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, së bashku me Odën e Inxhinierëve, është ende në fazën fillestare të procesit të licensimit. Aktualisht, shumë inxhinierë janë ende në pritje të procesit të licensimit, dhe ky proces sapo ka filluar të zhvillohet nga Oda e Inxhinierëve. Kërkesa për një licencë të tillë mund të krijojë një hendek të panevojshëm dhe të padrejtë në mes të inxhinierëve që janë ende në pritje të përfundimit të këtij procesi dhe atyre që e kanë marrë licencën më herët. Konsiderojmë se kërkesa për përvojë pune prej së paku 6 vite pas diplomimit është një garanci e mjaftueshme për të siguruar cilësinë dhe kompetencën e Menaxherit të Projektit. Për këto arsye, propozojmë që të largohet ose të zëvendësohet kjo kërkesë me kritere të tjera që nuk diskriminojnë ndaj inxhinierëve që janë ende në procesin e licensimit nga Oda e Inxhinierëve.

Një Inxhinier i Diplomuar i Ndërtimtarisë me master – Drejtimi Konstruktiv, me përvojë pune min.3 vite pas diplomimit, i licensuar nga Ministria e Mjedisit, planifikimit hapsinor dhe Infrastruktures- Licenca A,

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, së bashku me Odën e Inxhinierëve, është ende në fazën fillestare të procesit të licensimit. Aktualisht, shumë inxhinierë janë ende në pritje të procesit të licensimit, dhe ky proces sapo ka filluar të zhvillohet nga Oda e Inxhinierëve. Kërkesa për një licencë të tillë mund të krijojë një hendek të panevojshëm dhe të padrejtë në mes të inxhinierëve që janë ende në pritje të përfundimit të këtij procesi dhe atyre që e kanë marrë licencën më herët.

Në dokumentin e tenderit, është kërkuar që të ofrohen Licenca A vetëm për inxhinierët me drejtim Elektroteknik dhe Konstruktiv. Në ndërkohë, për inxhinierët e tjerë nuk është kërkuar një licencë e tillë pavarësisht që edhe të tjerët janë inxhinierë të cilët mund të licensohen nga Oda e Inxhinierëve. Kjo lë hapësirë për dyshime të bazuara se procedura është formuluar për të favorizuar një operator ekonomik të caktuar. Nëse Licenca A konsiderohet e rëndësishme për përmbushjen e detyrave profesionale, atëherë ajo duhet të kërkohej në mënyrë të barabartë për të gjithë inxhinierët e përfshirë në projekt dhe jo vetëm për inxhinier të caktuar nëse nga licenca varet profesionalizmi. Në të kundërtën, nëse nuk ka arsye specifike që të justifikojnë këtë dallim, kërkesa për Licenca A duhet të hiqet për të gjithë drejtimet. Sugjerojmë që të përfshihen kritere të qarta dhe objektive që trajtojnë të gjithë operatorët ekonomikë në mënyrë të drejtë dhe të barabartë. Kjo do të shmangë çdo dyshim mbi favorizimin e një operatori të caktuar.

3.10 Një inxhinier apo Master I Mjedisit I diplomuar me minimum 6 vite pervoj pune pas diplomimit, i qertifikuar si Asbestos Profesional Training –

Duke u bazuar në paramasën dhe parallogaritë e përfshira në dokumentacionin e tenderit, nuk janë parashikuar punime që përfshijnë materialin asbest apo që kërkojnë punë demolimi të materialeve që përmbajnë asbest. Për rrjedhojë, kërkesa për certifikim si Asbestos Professional Training nuk është e nevojshme për këtë projekt. Në përputhje me parimet e transparencës dhe konkurrencës së drejtë, kërkesat për certifikime duhet të jenë të justifikuara dhe të lidhura ngushtë me natyrën dhe kërkesat teknike të projektit.

Konsiderojmë se kërkesa për përvojë pune prej së paku 6 vite pas diplomimit është një garanci e mjaftueshme për të siguruar cilësinë dhe kompetencën e Menaxherit të Projektit. Për këto arsye, propozojmë që të largohet ose të zëvendësohet kjo kërkesë me kritere të tjera që nuk diskriminojnë ndaj inxhinierëve që janë ende në procesin e licensimit nga Oda e Inxhinierëve.

Në kontratë nuk parashikohet demolimet siq ka pretenduar AK në përgjigjien e kërkesës për rishqyrtim pasi që edhe në paramasë dhe parallogari, në përshkrim teknik dhe në projektin e prezantuar në epokurim nuk është parë që ka materiale të tilla as në gjendjen në teren, prandaj kërkesa për certifikim në këtë fushë është e panevojshme dhe e paarsyeshme. Kjo certifikatë nuk lidhet në mënyrë direkte me aktivitetet dhe detyrat që do të realizohen në kuadër të projektit, dhe si e tillë, kjo kërkesë mund të kufizojë pa nevojë pjesëmarrësit e kualifikuar në tender.

Kërkesat duhet të bazohen vetëm në standardet profesionale që janë të domosdoshme për realizimin e suksesshëm të projektit.

- Ne dosjen e tenderit eshte kerkuar qe stafi qe duhet te angazhohet **punëtor per epoksid**, Në dosjen e tenderit është kërkuar që stafi i angazhuar të përfshijë punëtorë me përvojë për instalimin e materialit epoksid. Megjithatë, në paramasën dhe parallogarinë e projektit, materiali i përcaktuar për dyshemenë është linoleum, dhe jo epoksid. Kërkesat për stafin dhe kompetencat duhet të jenë në përputhje të plotë me materialet dhe punimet e përcaktuara në paramasë dhe parallogari.
- **c) Një Kamion me vinç me gjatesi mbi 14m per transportin e xhamave me ngritje te xhamit automatike me vakum**, - Megjithatë, sipas paramasës dhe parallogarisë, nuk janë planifikuar punime që përfshijnë demolimin apo montimin e dritareve, apo transportimin dhe vendosjen e xhamave. Kërkesa për pajisje të specializuara si kamioni me vinç duhet të justifikohet nga natyra dhe kërkesat teknike të projektit. Në mungesë të punimeve që përfshijnë montimin apo demolimin e xhamave, kjo kërkesë është e panevojshme nga ana e Autoritetit Kontraktues.

AK ka bërë shkelje të nenit 1 të LPP-së ku thuhet se: Vendimet e AK-ve, të mos ndikohen nga interesat personale, të karakterizohet me jo-diskriminim dhe me një shkallë të lartë të transparencës dhe, të jenë në përputhje me kërkesat procedurale dhe qenësore të këtij ligji. Autoriteti Kontraktues nuk ka vepruar në harmoni me nenin 6 të LPP-së, ku Autoritetet Kontraktuese janë të obliguara që të sigurojnë që fondet publike dhe burimet publike të përdoren në mënyrën më ekonomike, njëkohësisht duke marrë në konsideratë qëllimin dhe lëndën e prokurimit ashtu siç parashihet në nenin 6 të LPP-së.

Gjithashtu shihet qarte se AK ka bere shkelje te nenit 7 te LPP-së ku ne piken 1 thuhet se : Autoriteti kontraktues do ti trajtoj operatorët ekonomik në mënyrë të barabartë dhe jo- diskriminuese dhe do të veprojë në mënyrë transparente. Ndërsa në piken 2 thuhet : Autoriteti Kontraktues nuk do të ekzekutojë asnjëaspekt të aktivitetit të prokurimit në një mënyrë që redukton apo eliminon konkurrencën në mes të operatorëve ekonomik ose që diskriminon në dëm ose në të mirë të një ose më shumë operatorëve ekonomik.

Besojmë se i kemi elaboruar me shumë se sa që duhet shkeljet e AK-se ne këtë aktivitet te Prokurimit andaj, Duke u bazuar në dëshmitë që u cekën më lartë, kërkojmë nga OSHP që të merr:

VENDIM

APROVOHET, si e bazuar ankesa e OE "AAB Construction SHPK"

DETYROHET autoriteti kontraktues që të përpiloj njoftimin për kontratë dhe dosjen e tenderit konform ligjit të prokurimit publik dhe kriteret e të jenë të natyrës së kontratës.

9. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës, ne rast se përfshini pretendime për kompensim.

Mundësia e konkurimit.

10. Lista e dokumenteve (dëshmime) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni Ankesës dokumentet e renditura më poshtë:

- a) një kopje të publikimit të "Njoftimit për Kontratë"*
- b) Kërkesa për rishqyrtim*
- c) Vendimin e AK për kërkesën për rishqyrtim*

****Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.*